

Math Quest — Udhëzues për Blerësin

Si ta merrni dhe ta aktivizoni programin · G&A Consulting

Çfarë është Math Quest

Një program matematike në shqip për nxënësit e klasave **1 deri 12**. Punon në kompjuter me Windows, **pa internet** — mjafton ta instaloni një herë.

Rezultatet e fëmijës ruhen vetëm në kompjuterin tuaj. Asnjë e dhënë e fëmijës nuk dërgohet askund.

Çmimi	15 € për Shqipëri dhe Kosovë · 32 € nga jashtë
Licenca	Një kompjuter, pa afat — paguani një herë dhe e keni përgjithmonë

Blerja në pesë hapa

1 · Shkarkoni programin

Nga faqja **ga-guritome.com** → seksioni Math Quest → butoni i shkarkimit.

2 · Instalojeni

Hapni skedarin e shkarkuar.

Nëse Windows-i shfaq një dritare blu „Windows protected your PC“: kjo është normale për programe të vegjël pa certifikatë të shtrenjtë nënshkrimi. Klikoni **More info** → **Run anyway**, dhe instalimi vazhdon.

Ndiqui hapat e instaluesit. Në fund do të keni një ikonë Math Quest në desktop.

3 · Hapni programin dhe merrni ID-në

Në hapjen e parë del dritarja „**Aktivizo Math Quest**“, me ID-në e kompjuterit tuaj — diçka si MQ-DEV-XXXX-XXXX-XXXX.

Klikoni „**Nuk keni çelës? Kërkoni licencë**“.

4 · Plotësoni kërkesën

Shkruani **emrin**, **email-in** dhe zgjidhni **ku ndodheni**. ID-ja e pajisjes dhe **kodi i pagesës** dalin vetvetiu — nuk keni pse t'i shkruani.

Klikoni **Dërgo kërkesën**. Do t'ju shfaqet udhëzimi i pagesës: përfituesi, IBAN-i, shuma dhe kodi. Kopjojeni me butonin **Kopjo udhëzimin** — do t'ju duhet te banka.

5 · Kryeni pagesën

Bëni transfertën nga banka juaj ose nga aplikacioni i telefonit.

E rëndësishme: te fusha e **përshtimit** të transfertës shkruani **kodin e pagesës** (p.sh. MQ-7K2P). Ky kod na tregon se cila pagesë i përket cilës kërkesë. Pa të, çelësi vonon.

Nga jashtë Shqipërisë, përdorni IBAN-in dhe kodin SWIFT që shfaqen te udhëzimi.

Aktivizimi

Brenda **24 orësh** nga konfirmimi i pagesës do të merrni me email çelësin, në formatin MQ-2026-XXXX-XXXX.

1. Hapni Math Quest
2. Te dritarja e aktivizimit, **ngjitni** çelësin te fusha „Çelësi i licensës“
3. Klikoni **Aktivizo**

Programi hapet i plotë. Dritarja e aktivizimit nuk do të dalë më.

Këshillë: ngjiteni çelësin me kopjim, mos e shkruani me dorë — një shkronjë e gabuar dhe nuk punon.

Pyetje të shpeshta

Sa kompjutera mbulon një licencë?

Një. Çelësi lidhet me atë kompjuter dhe nuk punon në një tjetër.

Po nëse ndërroj kompjuterin, ose ma formatojnë?

Na shkruani me ID-në e re të pajisjes. **Çelësi i parë i ri jepet falas.** Për ndërrime të mëpasshme aplikohet një tarifë e vogël, që ju komunikohet paraprakisht.

A skadon licenca?

Jo. Paguani një herë.

A duhet internet për ta përdorur?

Jo. Interneti duhet vetëm një herë, kur dërgoni kërkesën. Loja punon plotësisht offline.

Sa fëmijë mund ta përdorin?

Sa të doni, në atë kompjuter. Programi mban profile të veçanta me rezultatet e secilit.

Nuk kisha internet kur plotësova formën.

Nuk ka problem. Kërkesa ruhet dhe dërgohet vetvetiu sapo të lidheni. Ose kopjoni tekstin që ju shfaqet dhe na e dërgoni me email.

Çelësi nuk punon.

Shpesh është gabim shkrimi. Provoni ta kopjoni dhe ta ngjitni. Nëse prapë jo, na dërgoni një pamje ekrani të dritares së aktivizimit dhe e zgjidhim.

Nëse diçka nuk shkon

Na shkruani te **guritome@gmail.com** dhe përshkruani problemin. Nëse mundeni, bashkëngjitni një pamje ekrani.

Nëse programi nuk instalohet, nuk aktivizohet ose nuk punon siç përshkruhet, dhe nuk ia dalim ta zgjidhim brenda **14 ditësh** nga marrja e çelësit, ju kthejmë të gjithë shumën e paguar.

G&A Consulting — Dipl.-Ing. Guri Tome

guritome@gmail.com · +355 68 207 4209 · ga-guritome.com

Përgjigjemi zakonisht brenda 48 orësh.